

VENDIM
Nr.139, datë 22.7.2004

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR
PËRGATITJEN E PROJEKTLIGJIT “PËR NDARJEN E RE ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 144, datë 9.9.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Kuvendit për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijohet Komisioni i Posaçëm i Kuvendit për përgatitjen e paketës ligjore për reformën e re administrativo-territoriale dhe për përgatitjen e projektligjit “Për ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”.

II. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit përbëhet nga 16 anëtarë mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë, nga të cilët 8 anëtarë janë përfaqësues të pozitës dhe 8 anëtarë janë përfaqësues të opozitës. Komisioni kryesohet nga 2 bashkëkryetarë, një nga pozita dhe një nga opozita, të cilët zgjidhen nga Komisioni në mbledhjen e tij të parë. Komisioni zgjedh nga gjiri i tij edhe sekretarin e Komisionit.

Në përberje të Komisionit të Posaçëm të Kuvendit caktohen;

- | | |
|---------------------|------------------|
| 1. Ylli Buçi | PSSH |
| 2. Niko Faber | PSSH |
| 3. Taulant Dedja | PSSH |
| 4. Stefan Çipa | PSSH |
| 5. Lekë Çukaj | PSDSH |
| 6. Neritan Ceka | QLD |
| 7. Ndue Preka | PAASH |
| 8. Ndre Legisi | LSI |
| 9. Fatos Beja | PD |
| 10. Luan Skuqi | PD |
| 11. Luigj Gjoka | PD |
| 12. Sali Shehu | PD |
| 13. Neritan Alibali | PR |
| 14. Ilir Berzani | PDr |
| 15. Shpëtim Roqi | LZHK |
| 16. Alfred Çako | Grupi i Djathtë. |

III. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit do të fillojë nga veprimtaria në datën e konstituimit të tij dhe mbaron veprimtarinë më 30.4.2005.

IV. Pranë Komisionit të Posaçëm të Kuvendit ngrihet dhe funksionon grupi i ekspertëve, numri, afatet e punës dhe detyrat specifike të të cilëve përcaktohen me vendim të Komisionit. Në përbërje të tij ky Komision ka edhe sekretarinë teknike me ekspertë nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

V. Komisioni i Posaçëm i Kuvendit vepron sipas procedurës së përcaktuar për komisionet e përhershme në nenet 52-68 të Rregullores së Kuvendit.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi